




Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY



PSH.nr. 258/19

PANELI SHQYRTUES, i emëruar nga kryetari në bazë të nenit 105 dhe nenit 106 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, në përbërje : z.Nuhi Paçarizi– Kryetar, z.Blerim Dina- Referues, z.Goran Milenković- Anëtar, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga operatori ekonomik: “Pastor Kosova - shpk” kundër njoftimit për dhënie të kontratës ku i rekomanduar për dhënie të kontratës nga ana e AK – së është OE “DPZ BESRTI KZ SERVIS ”lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull : “Servisimi i aparateve për fikjen e zjarrit në ndërtesat Qeveritare” me numër të prokurimit: 202-19-033-221 iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) Ministria e Administratës Publike (MAP) më datën 20.06.2019 mori këtë:

V E N D I M

I. APROVOHET, pjesërisht si e bazuar ankesa e operatorit ekonomik: “Pastor Kosova - shpk” kundër njoftimit për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Servisimi i aparateve për fikjen e zjarrit në ndërtesat Qeveritare” me numër të prokurimit: 202-19-033-221 iniciuar nga Autoriteti Kontraktues AK- Ministria e Administratës Publike (MAP).

II. ANULOHET njoftimi për dhënie të kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “Servisimi i aparateve për fikjen e zjarrit në ndërtesat Qeveritare” me numër të prokurimit: 202-19-033-221 AK- Ministria e Administratës Publike (MAP) dhe aktiviteti i prokurimit kthehet në **Rivlerësim**.

III. Autoriteti Kontraktues në afat prej 10 ditësh duhet ta informoj me shkrim Panelin Shqyrtues për të gjitha veprimet e ndërmarra lidhur me këtë aktivitet të prokurimit.

IV. Mos respektimi i këtij vendimi, detyron Panelin shqyrtues që konform dispozitave ligjore të nenit 23.9 dhe 131 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092, të ndërmarr masa ndaj Autoritetit Kontraktues.

V.Me qenë se ankesa e operatorit ekonomik ankues“Pastor Kosova - shpk” aprovohet pjesërisht si e bazuar, i bëhet kthimi i tarifës së ankesës në shumën e deponuar me rastin e parashtrimit të ankesës.

VI. Obligohet operatori ekonomik ankues që konform nenit 33 pika 6 të rregullores së punës së OSHP-së, në afat prej gjashtëdhjetë (60) ditësh të bëjë kërkesë për kthim të sigurimit të ankesës, në të kundërtën ju bëhet konfiskimi i depozitës dhe këto mjete kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës.

ARSYETIM

Njoftimi për kontratë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit është bërë me dt:19.03.2019

Data e hapja së ofertave:11.04.2019. Data e njoftimit me letër standarde për tenderuesit te pasuksesshëm: 16.05.2019. Kundër njoftimit te autoritetit kontraktues lidhur me këtë aktivitetit të prokurimit, operatori ekonomik“Pastor Kosova - shpk” me dt: 20.05.2019, ka bërë kërkesë për rishqyrtim tek autoriteti kontraktues.Autoriteti Kontraktues- “Ministria e administratës publike” me datën 24.05.2019ka marrë vendim që të refuzohet kërkesa për rishqyrtim e OE: “Pastor Kosova - shpk” si të pa bazuar.

Operatori ekonomik ankues “Pastor Kosova - shpk” si palë e pa kënaqur, ka deponuar ankesë në OSHP, me29.05.2019 me nr. 258/19,kundër njoftimit për dhënie te kontratës lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull“Servisimi i aparateve për fikjen e zjarrit ne ndërtesat Qeveritare” me numër të prokurimit: 202-19-033-221 të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) -“Ministria e administratës publike” duke pretenduar ne shkelje te këtyre dispozitave të LPP-së:

- Nenit 7,59,si dhe neni 72të Ligjit për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës

Organi Shqyrtues i Prokurimit,konform nenit 113 dhe 114 të LPP-së me datë: 05.06.2019ka autorizuar ekspertin shqyrtuesprofesional tëprokurimit për të shqyrtuar vlefshmërinë e të gjitha pretendimeve të palës ankimore.

Eksperti Shqyrtuesprofesional në raportin e dt:12.06.2019,lidhur me pretendimin ankimore te OE ankues “Pastor Kosova - shpk” në finalizim te analizimit dhe shqyrtimitte këtij aktiviteti te prokurimit, konstaton si në vijim:

Lidhur me pretendimin e OE ankues,se AK Ministria e Administratës Publike ka bërë shkelje te nenit 7 ,59 dhe 72LPP-se,eksperti shqyrtues konstaton se këto pretendime janë te pabazuara për arsye se AK Ministria e Administratës Publike duke u bazuar në Ligjin Nr.04/L-042 PER PROKURIMIN PUBLIK TE REPUBLIKES SE KOSOVES, I ndryshuar dhe i plotësuar ne Ligjin Nr.04/L-237,Ligjin Nr.05/L-068 dhe ligjin Nr.05/L-092 Neni 72 Dokumentacioni dhe informacioni shtesë dhe RREGULLAT dhe UDHEZUESI OPERATIV për PROKURIMIN PUBLIK neni 39 Sqarimi i Tenderëve,me date 19.04.2019 ka kërkuar nga operatori ekonomik i cili ka ofruar çmimin me te ulet ta plotësoj tenderin me dokumentet e munguara. Operatori në fjalë i është përgjigjur AK dhe pas pranimit te tere dokumentacionit te kërkuar e ka shpallur fitues.

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues i propozon panelit shqyrtues që ankesa e OE ankues “PASTOR KOSOVA”-Prishtinë të hedhet si e pa bazuar (për arsyen që u cek tek përgjigja në pretendimin nr.1) dhe rekomandon *te mbetet ne fuqi* Njoftimi mbi vendimin e AK Ministria e Administratës Publike.

Operatori Ekonomik ankues përmes parashtresës me shkrim të datës:14.06.2019 ka njoftuar Panelin shqyrtues senukpajtohetme raportin e ekspertit shqyrtues.

Autoriteti Kontraktues përmes parashtresës me shkrim të datës: 13.06.2019 ka njoftuar Panelin shqyrtues se pajtohet me raportin e ekspertit shqyrtues.

Në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 20.06.2019, ku kanë qenë prezent paneli shqyrtuesi, eksperti shqyrtues profesional, përfaqësuesi i OE ankues, përfaqësuesi i autoritetit kontraktues, ku shqyrtuan shkresat e lëndës duke e bërë kontrollimin dhe analizimin e dokumentacionit për procedurën e prokurimit i cili përbëhet nga: autorizimi i inicimit të aktivitetit të prokurimit, njoftimi për kontratë, ankesa e operatorit ekonomik, raporti i ekspertit shqyrtues, parashtresat e palëve në procedurë.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i OE-ankues ankues z. Imerideklaroj: Ne nuk jemi pajtuar me raportin e ekspertit shqyrtues për arsye se ne raport ceket se me dt 19.04.2019 AK ka kërkuar nga OE i cili ka ofruar çmimin me te lire qe te plotësoj Tenderin me dokumentet e munguara OE ne fjalë i është përgjigjur Autoriteti Kontraktues dhe pas pranimit te dokumentacionit te kërkuar është shpallur fitues. Ne bazë te dokumentacioneve dhe vendimeve e vërteta është me ndryshe me 19.04.2019 OE “BESARTI” qe është propozuar për kontrate i janë kërkuar dokumentet e qe i kanë munguar ne oferte dhe pas kalimit te afatit prej 5 ditësh Autoriteti Kontraktues ka shpall njoftimin me 26.04.2019 ku OE “BESARTI” e ka eliminuar me arsyetime: CITOJ : ju ende dosjen tuaj nuk keni bashkangjitur listën e kontratave 2. Listën e

stafit. 3. CV-ite. 4. Kontratat e punës. % veglat e punës. 6. Material te mjaftueshëm për realizimin e kësaj kontrate. 7 . Deklaratat TATIMORE vjetore për 3 vitet e kaluara” te gjitha këto janë kërkuar nga Autoriteti Kontraktues mirëpo ju nuk keni kthyer përgjigje a i posedoni apo jo” me te njëjtin vendim ne vend se ne te shpallemi fitues ne jemi eliminuar se na mungon deklarata nen betim qe ne fakt ka qenë pjese e ofertës deklarata nen betim, ne nuk e besojmë se Autoriteti Kontraktues e ka bere me qellim te fshehe dokumentin tone mirëpo kemi te drejte te dyshojmë. Ne kërkesën për rishqyrtim kërkesa jone është marr e bazuar. Ne në ankesën tone nuk kemi pasur pretendime ankimore ndaj OE te tjerë. Panelit i dorëzoj Njoftimin mbi vendimin e Autoriteti Kontraktues i dt 26.04.2019.

Gjatë prezantimit në seancë përfaqësuesi i AK-së z. Sopa deklaroj: Autoriteti Kontraktues pas vlerësimit dhe vendimit te pare zyrtari i prokurimit kërkon nga OE me i lire qe pretendon me shpall fitues sqarime dhe kompletim te dokumentacione me date 19.04.2019 mirëpo nga i njëjti nuk merr përgjigje, është e vërtetë se “Pastor Kosova” është eliminuar për deklaratën nen betim mirëpo sistemi i E-prokurimit nga një here po ka probleme. OE Pretendues “Pastor Kosova” ka bere ankesë dhe Autoriteti Kontraktues pas analizës se dokumentacionit e pranon ankesën si te bazuar edhe lenden e kthen ne rivlerësim, pas krijimit te komisionit te ri vlerësues Autoriteti Kontraktues e bene rivlerësimin e ofertave dhe ne te njëjtën mënyrë sipas nenit 72 te LPP-së kërkon nga OE me i lire për kompletim te dokumentacionit dhe i njëjti i përgjigjet me kompletim dokumentacioni. Autoriteti Kontraktues mendojmë qe ka bere vendimin me te drejt duke shpërblyer OE me te lire ne gare i cili i plotëson kërkesat e DT-se dhe njoftimit për kontrate.

Gjatë prezantimit në seancë Ekspertja Shqyrtuese znj. Doda deklaroj: Mbetem prapa raportit te dhen në ekspertizë.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i OE-së deklaroj: Kërkojmë nga paneli shqyrtues te aprovoj ankesën tone si te bazuar dhe te kthehet lënda ne rivlerësim.

Në fjalën përfundimtare përfaqësuesi i AK-së deklaroj: Autoriteti Kontraktues Kërkojmë qe te mbetet në fuqi vendimi i Autoriteti Kontraktues dhe nijeti te shpërblehet me kontrate .

Paneli shqyrtues pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, shqyrtimit të pretendimeve ankimore të OE ankues, konstatimeve, analizës konkrete dhe rekomandimeve të ekspertit shqyrtues profesional , deklarimit të palëve në procedurë, diskutimeve dhe shoshitjes së provave në tërësi gjatë seancës për shqyrtim kryesor, sqaron se fillimisht operatorin ekonomik OE “Pastor Kosova” – shpk, AK e ka eliminuar duke konsideruar se i njëjti nuk ka deklaruar nën betim. I pa kënaqur me këtë vendimit te

autoriteti kontraktues, OE në fjalë ka parashtruar ankesë, ku e njëjta ankese është aprovuar dhe aktiviteti i prokurimit në fjalë është kthyer në Rivlerësim.

Paneli shqyrtues sqaron se, autoriteti kontraktues ka formuar komisionin për rivlerësim të aktivitetit të prokurimit në fjalë dhe ky komision sipas nenit 72 të LPP-së kërkon nga OE me i lire për kompletim të dokumentacionit dhe i njëjti i përgjigjet me kompletim dokumentacioni.

Lidhur me deklarin e ankuesit në seancën për shqyrtim kryesor se :AK ka kërkuar nga OE i cili ka ofruar çmimin me te lire që të plotësoj Tenderin me dokumentet e munguara, OE në fjalë i është përgjigjur autoriteti kontraktues dhe pas pranimit të dokumentacionit të kërkuar OE “BESARTI” është shpallur fitues. Ne bazë të dokumentacioneve dhe vendimeve të vërteta është me ndryshe me 19.04.2019 OE “BESARTI” që është propozuar për kontrate i janë kërkuar dokumentet e që i kanë munguar në oferte dhe pas kalimit të afatit prej 5 ditësh Autoriteti Kontraktues ka shpall njoftimin me 26.04.2019 ku OE “BESARTI” e ka eliminuar me arsye: CITOJ: ju ende dosjen tuaj nuk keni bashkangjitur listën e kontratave 2. Listën e stafit. 3. CV-ite. 4. Kontratat e punës, 5. veglat e punës 6. Material të mjaftueshëm për realizimin e kësaj kontrate. 7 . Deklaratat TATIMORE vjetore për 3 vitet e kaluara” të gjitha këto janë kërkuar nga Autoriteti Kontraktues mirëpo ju nuk keni kthyer përgjigje a i posedoni apo jo” .

Paneli shqyrtues konstaton se me rastin e rivlerësimit autoriteti kontraktues duhet të vërtetoj se dokumentet cilat i ka kërkuar nga OE i rekomanduar për dhënie të kontratës a janë kërkuar duke u bazuar në dispozitat e LPP-së dhe se të njëjtat dëshmi a lejohet të kërkohen si dokumente plotësuese ashtu siç parashihet me nenin 59 dhe 72 të LPP-së.

Duke pas parasysh faktin autoriteti kontraktues me rastin e rivlerësimit, respektivisht komisioni i vlerësimit ka kërkuar nga OE me çmim të lire plotësim të një numerik të konsiderueshëm të dokumenteve, Paneli shqyrtues konstaton se me rastin e rivlerësimit autoriteti kontraktues duhet të konstatoj se dëshmitë e kërkuara për plotësim sipas nenit 72 të LPP-së a janë kërkuar në pajtim me nenin 59 dhe 72 të LPP-së.

Paneli shqyrtues vjen në përfundim se ekzaminimi vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve nuk është bërë konform nenit 59 të LPP-së dhe njëkohësisht nuk është respektuar edhe neni 60 i LPP-së kriteri kryesor për dhënie të kontratës e që ka qenë tenderi i përgjegjshëm me çmim më të ulët.

Prandaj obligohet autoriteti kontraktues që gjatë rivlerësimit të ofertave dhe në të ardhmen ti përmbahet në detaje të gjitha dispozitat e LPP-së dhe kërkesave të dosjes së tenderit dhe të njoftimit për kontratë.

Paneli shqyrtues konform nenit 117 të LPP-së, si dhe duke u bazuar në provat e prezantuara si më lart vendosi si në diapozitiv të këtij vendimi.

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet vetëm Gjykatës themelore-Departamentit për çështje Administrative për kompensim dëmi ne afat prej 30 ditësh nga data e pranimi të vendimit .

Kryesuesi i Panelit Shqyrtues
Nuhî Paçarizi



Vendimi t'i dorëzohet:

1x1 AK –“Ministria e Administratës Publike”

1x1 OE-“Pastor Kosova - shpk”

1x1 Arkivës së OSHP-së;

1x1 Për publikim në web- faqe të OSHP-së.